

Relievi i Bjeshkëve të Nemuna është i thyer, me majë të shumta, gryka të thella, shpatet të pjerrëta, lugina lumore të tipit alpin dhe fenomene të tjera natyrore.

Sa i përket pasurisë së biodiversitetit, impresionon fakti se në Parkun Kombëtar i Bjeshkëve të Nemuna jetojnë pothuajse 2000 lloje të ndryshme bimësh, që përbëjnë gjysmën e florës së përgjithshme të Malit të Zi dhe afërsisht një të pestën e florës së përgjithshme ballkanike. Parku Kombëtar është i pasur me pyje. Gjithashtu, në Bjeshkë të Nemuna janë regjistruar shumë lloje endemike, që përbëjnë një pjesë të rëndësishme të florës endemike të Gadishullit Ballkanik.

Bota shtazore është po ashtu jashtëzakonisht e larmishme. Parku Kombëtar i Bjeshkëve të Nemuna dallohet si qendra më e rëndësishme e diversitetit të herpe - tofaunës (zvarranikëve dhe amfibëve). Kur flasim për ornitofaunën (botën e shpendëve), në këtë zonë janë regjistruar mbi 180 lloje zogjsh, çka i bënë Bjeshkët e Nemuna masiv malor me ornitofaunën më të pasur në Mal të Zi dhe më gjjerë. Po ashtu, vëmendje tërheq edhe prania e disa llojeve të rrezikuara dhe të mbrojtura të gjitarëve në këtë zonë.

Banorët më të shpeshtë të pyjeve të Prokletive janë: lepurët, ujqit, arinjtë e murrmë, derrat e egër, dhitë e egra dhe drerët. Habitatet e tyre përfshijnë zonat e larta malore, luginat e Ropojanës dhe të Grebajës, komplekset pyjore, liqenet malore dhe lumenjtë.



# Nacionalni Park Prokletije

Visoki planinski vijenac Prokletije nalazi se na dodiru Dinarskog planinskog sistema i Šarskih planina, na granici tri Balkanske zemlje – Crne Gore, Kosova i Albanije. Prostire se na više od 3500 m<sup>2</sup> površine i 650 km dužine. Prokletije predstavljaju jedan od najzamršenijih, najnepristupačnijih ali ujedno i najdivnijih planinskih masiva na Balkanskom poluostrvu. Čini ga preko 40 planinaskih vijenaca koji se preplicu i ukrštaju, ispunjavajući prostor između Zetske kotline na jugu, doline Drima na istoku, Metohijske kotline na sjeveru i Plavsko – gusinjske kotline i doline gornjeg Ibra na zapadu.

Nacionalni park Prokletije najmladi je park u Crnoj Gori ali i u dinarskom predjelu. Službeno je imenovan nacionalnim parkom 2009.godine, prvenstveno zbog bogatstva flore i faune koje ovo područje karakterišu kao centar viskoplaninskog diverziteta. Osim toga, karakteristika Prokletija su i specifičan reljef i bogatstvo voda. Nacionalni Park Prokletije prostire se na teritoriji Plava i Gusinja. Zbog svoje ljepote, nepristupačnosti, bogatstva biodiverziteta postaje omiljena destinacija za sve veći broj turista, ljubitelja prirode, naročito planinara i alpinista.

Na teritoriji parka nalaze se dva rezervata prirode, odnosno područja sa izuzetnim prirodnim vrijednostima koja zavrijeđuju posebnu florističku i ambijentalno-estetsku pažnju – Hridsko jezero (Plav) i Volušnica (Gusinje).



Vargmali i lartë malor i Bjeshkëve të Nemuna ndodhet në takimin e sistemit malor Dinarik dhe maleve të Sharrit, në kufirin e tri vendeve ballkanike – Malit të Zi, Kosovës dhe Shqipërisë. Ai shtrihet në më shumë se 3,500 km<sup>2</sup> sipërfaqe dhe ka një gjatësi prej 650 km. Bjeshkët e Nemuna përfaqësojnë një nga masivet më të ndërlikuara, më të paarritshme, por edhe më të mrekullueshme malore në Gadishullin Ballkanik. Përbëhet nga mbi 40 vargje malore që ndërthuren dhe kryqëzohen, duke mbushur hapësirën ndërmjet Ultësirës së Zetës në jug, luginës së Drinit në lindje, Ultësirës së Metohisë në veri dhe ultësirës Plavë-Guci dhe luginës së Ibrit të sipërm në perëndim. Parku Kombëtar i Bjeshkëve të Nemuna është parku më i ri në Mal të Zi dhe gjithashtu në rajonin Dinarik. Zyrtarisht u shpall park kombëtar në vitin 2009, kryesisht për shkak të pasurisë së florës dhe faunës, që e karakterizojnë këtë zonë si një qendër të biodiversitetit të lartë malor. Përveç kësaj, Prokletitë karakterizohen edhe nga reliivi specifik dhe pasuria ujore.

Parku Kombëtar i Bjeshkëve të Nemuna shtrihet në territorin e komunave të Plavës dhe Gucisë. Për shkak të bukurisë së tij, vështirësisë në qasje dhe pasurisë së biodiversitetit, ky park po bëhet një destinacion gjithnjë e më i preferuar për turistët, adhuruesit e natyrës, veçanërisht alpinistët dhe alpinistët profesionistë.

Brenda territorit të parkut ndodhen dy rezervate natyrore, respektivisht zona me vlera të jashtëzakonshme natyrore që meritojnë vëmendje të veçantë floristike dhe estetike-ambientale: Ljeni i Hridit (Plavë) dhe Volushnica (Guci).

Reljef Prokletija je razuden, sa brojnim visovima, klisurama, strmim padinama, riječnim dolinama alpskog tipa i drugim prirodnim fenomenima. Kada je riječ o bogatstvu biodiverziteta, impresionira činjenica da u NP Prokletije živi skoro 2000 različitih biljnih vrsta što je polovina ukupne flore u Crnoj Gori i skoro petina ukupne balkanske flore. Nacionalni park obiluje bogatstvom šuma pri čemu skoro polovina ima prašumski karakter. Takođe, na Prokletijama je zabilježen veliki broj endema koji čine značajan dio endemične flore Balkanskog poluostrva.

Životinjski svijet je takođe izuzetno raznovrstan. Nacionalni park Prokletije se izdvaja kao najznačajniji centar diverziteta herpetofaune. Kada je riječ o ornitofauni, na ovom području je registrovano preko 180 vrsta ptica, što Prokletije opisuje kao planinarski masiv sa najbogatijom ornitofaunom u Crnoj Gori, pa i šire. Pažnju privlači i činjenica da na ovom području zabilježeno i prisustvo ugroženih i zaštićenih vrsta sisara. Najčešći stanovnici prokletijskih šuma su: zec, vuk, mrki medvjed, divlja svinja, divokoza, srna. Njihova staništa su visokoplaninski regioni, doline Ropojane i Grebaje, šumski kompleksi, planinska jezera i rijeke.